



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 774/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazic dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtrri, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 11.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN si të palejueshme ankesat: Anr.774/13, Anr.775/13, Anr.776/13, Anr.777/13, Anr.778/13, Anr.779/13, Anr.780/13, Anr.781/13, të datës 11.11.2013, të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Vushtrri.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.774/13, Anr.775/13, Anr.776/13, Anr.777/13, Anr.778/13, Anr.779/13, Anr.780/13, Anr.781/13, me datë 11.11.2013, nga subjekti politik AAK dega në Vushtrri si dhe një shkresë përmbledhëse të ankesave të sipërshenuar në të cilën pretendohet se pas publikimit të rezultateve preliminare nga KQZ-ja, për komunën e Vushtrrisë, kemi vërejtur shumë pasaktësi, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin e publikuar, këtë e vërtetojmë duke e bërë krahasimin nëpërmjet Formularit të Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve (FPR). Sipas parashtresës të ankesave, nga rezultatet e publikuara në mënyrë elektronike nga KQZ-ja, kanë konstatuar se ekziston një dallim shumë i madh që ndikon drejtpërdrejtë në rezultatin e publikuar.

- Në ankesën Anr.774/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në Qendrën e Votimit (QV) 2727B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoj rinumërimin e votave në qendrën e votimit.
- Në ankesën Anr.775/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2706B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoj rinumërimin e votave në qendrën e votimit.
- Në ankesën Anr.776/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2704B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoj rinumërimin e votave në qendrën e votimit.

- Në ankesën Anr.777/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2713B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoi rinumërimin e votave në qendrën e votimit.
- Në ankesën Anr.778/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2714B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoi rinumërimin e votave në qendrën e votimit.
- Në ankesën Anr.779/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2701B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoi rinumërimin e votave në qendrën e votimit.
- Në ankesën Anr.780/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2713B, dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoi rinumërimin e votave në qendrën e votimit.
- Në ankesën Anr.781/13 të datës 11.11.2013, pretendohet se në QV 2729B dyshoj se më mungojnë votat, prandaj kërkoi që të më rinumërohen votat në qendrën e votimit.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të palejuar ngase rezultati preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment.

Po ashtu për rezultat preliminarë në vendvotim është dashtë të parashtrihen në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së i cili parasheh “Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj”.

Në rastin konkret ankesat janë parashtruar nga kryesia e subjektit politik AAK dega në Vushtrri, nga kjo del se, ankesat në fjalë nuk janë parashtruar nga personat e autorizuar sipas nenit 102.1 të LZP-së.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu

PZAP-i refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 774/2013 më datën 11.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: *Ndaj këtij vendimi siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*